

Nr. 181/20  
dt. 29/05/2020



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**  
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**



Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të dt. 26.05.2020, parashtruar nga subjekti: “ Er-Lis”sh.p.k. & “ El-Bau “sh.p.k. me seli në Vitomiricë / K. Pejë, Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të kërkesës të subjektit në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 6 lidhur me pikën 10 paragrafi 10.1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, më datën 29.05.2020, merr këtë:

## V E N D I M

- 1. Refuzohet** Kërkesa për rishqyrtimin lidhur me Njoftimin Letër për Tenderuesin e Pasuksesshëm të subjektit në procedurë: “Er-Lis”sh.p.k. & “ El-Bau “sh.p.k. me seli në Vitomiricë / K. Pejë, **si e pabazë.**
- 2. Vërtetohet si i bazuar** Vendimi i Autoritetit Kontraktues – Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik për anulimin e aktivitetit në bazë të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të dt. 22.05.2020

## A r s y e t i m

Njësia Kërkuese e A.K. si inicuese e aktivitetit të prokurimit” Pastrimi dhe larja e rrugëve në qytet “ ka parashtruar kërkesën për anulim të aktivitetit të prokurimit në fjalë për shkak se, si pasojë e gjendjes së krijuar pas shfaqjes së Pandemisë COVID 19 e cila ka përfshirë tërë botën, Specifikat Teknike për përmbushjen gjegjësisht ekzekutimin e kërkesave për pastrim dhe larje të rrugëve nuk përmbushin nevojat e domosdoshme të paraqitura si rezultat i paraqitjes së kësaj sëmundjeje. Sikurse ka konstatuar Njësia Kërkuese e A.K. vazhdimi i mëtejme i këtij procesi dhe kontrata eventuale e lidhur do ta dëmtoi dhe do ta bëjë të paefektshëm dhe jo të plotë procesin e pastrimit dhe larjes së rrugëve, për pasojë shërbimi i kërkuar do të ishte i mangët, ndërsa Kontrata do të ishte jo e zbatueshme, marrë parasysh dhe situatën epidemiologjike me sëmundjen infektive Covid 19.

Më tej Njësia Kërkuese e A.K. ka njoftuar se :

- me qëllim të ndryshimit të planit për larje, fshirje dhe dezinfektim;
- kompletimin dhe harmonizimin e planit me nevojat dhe sfidat e paraqitura si rezultat i paraqitjes së situatës epidemiologjike me Pandeminë COVID 19;
- marrë parasysh edhe faktin se ndryshimi i planit për fshirje implikon edhe rritjen-shtimin e numrit të rrugëve për pastrim, përdorimin e mjeteve dezinfektuese, e të cilat nuk kanë qenë pjesë e Specifikave Teknike paraprake, do të ketë ndikim direkt në rritjen e kostos financiar të vlerës së përgjithshme të parashikuar të kontratës 15 % deri në 20% nga vlera paraprake;

si rrjedhojë e të gjitha këtyre situatave ka ardhur edhe deri te ndryshimi i planifikimit buxhetor, andaj ka kërkuar nga Drejtoria për Prokurim Publik dhe Komisioni i Vlerësimit që ky aktivitet i prokurimit lidhur me projektin në fjalë të anulohet.

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik ( në tekstin e mëtejme A.K. ) duke vlerësuar kërkesat në fjalë, mare parasysh dhe qëllimin e këtij aktiviteti të prokurimit dhe efektet të cilat synohen të arrihen përmes këtyre ndryshimeve dhe plotësimeve në Specifikat Teknike dhe në qasjen për ekzekutimin e kontratës, qëllime këto të cilat në këtë fazë nuk mundë të plotësohen në

tërësi pa një ndërhyrje në Specifikat Teknike dhe në Përshkrim të shërbimeve, bazuar në nenin 1 lidhur me nenin 62 paragrafi 1 pika 1 të LPP-se lidhur me nenin 44.5 pika (ix) të RUOPP, për shkak se një shkelje ligji do të ndodhë dhe nuk mundë të parandalohet përmes një ndryshimi, bazuar dhe në Plotësimin dhe / ose shtimin e specifikave respektivisht kërkesave shtesë tani është a pamundur të bëhet, ka vendosur të miratoi kërkesën e Njësisë Kërkuese dhe të marrë vendim për anulimin e aktivitetit të prokurimit në fjalë.

Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues ( në tekstin e mëtejme A.K. ) si dhe Njoftimi letër për tenderuesin e pasuksesshëm për Ankuesin janë publikuar në platformën elektronike më dt. 22.05.2020, bazuar në dispozitat e nenit 43 të Rregullores mbi Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik.

Në Kërkesën për rishqyrtim, parashtruesi i kërkesës për rishqyrtim konsideron se me këtë rast A.K. ka shkelur dispozitat e LLP-së, saktësisht nenit 1- qëllimi, fushëveprimi, përjashtimet, përkufizimet, nenit 7 – barazia në trajtim/Jo diskriminimi, nenit 62-përfundimi i aktivitetit të prokurimit.

Autoriteti Kontraktues pasi i shqyrtoi pretendimet e Ankuesit të parashtruara në Kërkesë për Rishqyrtim dhe vlerësimin të provave në shkresat e lëndës, gjeti se Kërkesa e Ankuesit është e pabazë, për arsye se:

1. Procedura është zhvilluar bazuar në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, nenit e 33 paragrafi 1 ( Procedurë e Hapur );
2. A.K., që në fazën e parë të procesit të vlerësimin të tenderëve, sikurse u sqarua më lartë në këtë vendim, ka pranuar kërkesë nga Njësia Kërkuese e A.K. për anulim të këtij aktiviteti të prokurimit për arsyen bazike se vazhdimi i mëtejme me këtë aktivitet të prokurimit nuk mundë të arrihet qëllimi i dëshiruar i efekteve të shërbimeve të planifikuara si pasojë e ndikimit të pandemisë COVID-19, andaj pretendimi i Ankuesit se me këtë Vendim është shkelë neni 1 i LPP-së është krejtësisht i pabazuar dhe i paargumentuar për faktin se pikërisht vazhdimi i mëtejme me këtë aktivitet dhe eventualisht kontraktimi i shërbimeve jo të plota dhe jo efikase, ashtu sikurse ka vlerësuar dhe Njësia Kërkuese e A.K., do të bënte që mos të arrihet qëllimi dhe synimi i A.K. përmes aktivitetit të prokurimit të iniciuar më parë e tani të anuluar.
3. Më tej Autoriteti Kontraktues vlerëson se të gjithë tenderët e tenderuesve në aktivitetin e prokurimit në fjalë janë trajtuar në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese ndërsa, i gjithë procesi ka qenë transparent. I tërë aktiviteti i prokurimit është zhvilluar dhe ekzekutuar në atë mënyrë që mos të reduktoj dhe / ose eliminoi konkurrencën në mes të O.E. dhe po ashtu të mos diskriminoj në dëm ose në të mirë të një ose më shumë O.E. Vendimi për ta anuluar aktivitetin e prokurimit në fjalë është marrë në mes tjerash edhe në zbatimin e nenit 7 të LPP-së, në mes tjerash edhe për të mos diskriminuar dhe/ ose trajtuar barabartë ndonjë prej O.E. në proces.
4. Sikurse vlerëson A.K. vazhdimi i mëtejme i këtij procesi dhe kontrata eventuale e lidhur do të bënte që të shkelen dispozitat e nenit 1 të LPP-së sa i përket qëllimit që dëshirohet të arrihet me aktivitetin e prokurimit në fjalë dhe neni 6 sa i përket sigurimit që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Andaj, sikurse konstaton A.K., zbatimi i nenin 62 paragrafi 1 pika 1.1. të LPP-së lidhur me nenin 44.5 pika ( ix ) të ROUPP në këtë situatë është i bazuar dhe i drejtë në mënyrë që mos të vije deri te shkelja e dispozitave të nenit 1 dhe 6 të LP-së. Mbi këtë bazë A.K. vlerëson që pretendimi i Ankuesit se në këtë rast është shkelur neni 62 i LPP-së është i paqëndrueshëm dhe jo i saktë edhe për faktin se në kërkesën e Njësisë Kërkuese përveç shtimit të rrugëve që është i lidhur me kapacitetin teknik të O.E. pretendim ky i Ankuesit se ka kapacitet të mjaftueshëm teknik për ti kryer me sukses kërkesat e A.K., është parashikuar edhe plotësimi dhe inkorporimi, në Përshkrim të Shërbimeve, i shërbimeve shtesë që dëshirohet të blihen, sikurse janë edhe përdorimi i mjeteve të caktuara dezinfektuese, mënyra e ekzekutimit të shërbimeve me përdorimin e këtyre mjeteve, saktësimi i mjeteve dhe pajisjeve teknike adekuate që duhet ti ketë O.E. dhe në fund dhe parashikimi i kostos dhe sigurimi i mjeteve shtesë që janë të domosdoshme për këto shërbime.

Mbi bazën e të cekurave si më lartë, A.K. vlerëson se A.K., me vendimin e saj për të anuluar aktivitetin e prokurimit “ **Pastrimi dhe larja e rrugëve në qytet** “ nuk ka shkelur dispozitat e nenit 1 lidhur me Qëllimin e aktivitetit të prokurimit, nenin 7 lidhur me Barazinë në Trajtim/ Jo Diskriminimi dhe nenin 62 të LPP-së, ndërsa pretendimet e Ankuesit lidhur me këtë çështje janë të pabazë dhe jo të sakta. Nga sa u tha me lartë, e në përputhje me nenin 108/A pika 10 paragrafi 10.1 të LPP-së u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi pala mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa në OSHP duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas dërgimit të këtij vendimi.

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik  
K.R. nr. 017/2020 - datë 29/05/2020

Vendimi i dërgohet:

1. 1x Palës
2. 1 x DKP
3. 1 x Arkivit (1 kopje)

Drejtoria për Prokurim Publik

  
Hyda Dallku - ZPP